



## UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë  
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

### **SYLLABUS**

*Lënda: Teknologjia e Komunikimit në Biznes*

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - Informatika për Ekonomi
<b>Titulli i lëndës:</b>	<u>Teknologjia e Komunikimit në Biznes</u>
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative
<b>Viti i studimeve:</b>	viti i III-të, semestri i V-të
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 + 2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6
<b>Koha / lokacioni:</b>	Ligjërata: e martë 14:00-15:30 salla A26 Ushtrime: e martë 15:30-17:00 salla A26 Asistent: Refik Ramadani
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Ass. Dr. Ragmi MUSTAFA
<b>Detajat kontaktuese:</b>	+381 63 10 62 962; +386 49 47 49 52; ragmiu@hotmail.com
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Teknologjia e komunikimit në biznes ka filluar zhvillimin e saj që nga vitet 1837 dhe ka kaluar një rrugë të gjatë gjer në zhvillimet e ditëve të sotme. Komunikimi përmes rrjeteve kompjuterike në biznes është temë boshte që përpunohet në këtë kurs. Në vijim mirë përpunohen dhe temat: mediumet për transfer sinjalesh, sinjalet analoge dhe digjitale, topologjitë e rrjeteve, mbrojtja e rrjeteve, LAN protokolet, Internet protokolet dhe aplikacionet, teknologjitë me komutim qarqesh dhe Web aplikacionet. Modelimi dhe projektimi i këtyre sistemeve telekomunikuese në biznes paraqesin kuptimet kyçe për formimin e urave lidhëse ndërmjet hulumtimeve shkencore dhe praktikës. Shpjegimi i shembujve të komunikimit të mirë e funksional nga bazat e sistemeve të informacionit dhe praktikës në kohë reale. Planifikimi, menaxhimi, dizajni dhe shqyrtimi i projekteve telekomunikuese në biznes. Testimi i sistemeve telekomunikuese në biznes, mirëmbajtja e sistemeve, vlerësimi i produkteve komunikuese, dorëzimi i sistemeve të tilla shfrytëzuesëve të dedikuar.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i këtij kursi është që studentëve të nivelit bachelor t'u japë fillimisht njohuri themelore për lëndën mësimore dhe arsyet për ndërtimin e rrjeteve telekomunikuese dhe atyre kompjuterike të nivelit sa më të lartë cilësor. Organizimin e ekipit të punës në ndërtimin e sistemeve telekomunikuese biznesore dhe ndarjen e përgjegjësisë sipas shkathësive të anëtarve në ekip ose grup. Zgjedhjen e metodave dhe rrugëve sa më cilësore dhe funksionale në ndërtimin e sistemeve komunikuese, rrjeteve kompjuterike,

	<p>testimin e tyre dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e sistemeve. Përgjegjësitë e inxhinierëve të rrjetit telekomunikues në momentet e lëshimit të gabimeve në kodin programor si dhe ato teknike. Zbatimi i koncepteve teorike të teknologjisë moderne të komunikimit në biznes dhe në praktikë. Zhvillimi i projekteve të orjentuara në objekte. Gjetjen e veglave të përshtatshme në zgjidhjen e problemeve softuerike dhe atyre harduerike. Evaluimi i produkteve softuerike dhe teknologjisë së informacionit e komunikimit.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Studenti:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mësoj kombinimin e hulumtimit shkencor me praktikën dhe artin me shkencën me qëllim të ndërtimit të sistemeve të komunikimit në biznes sa më cilësor;</li> <li>- Të mësoj zbatimin e mësimëve sa herë që ballafaqohen me gjetjen e zgjidhjeve të problemeve të rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve telekomunikimi në biznes në jetën e përditshme;</li> <li>- Të mësoj përcjelljen e përparimit në ndërtimin e softuerit dhe lidhjen e tij me teknologjinë e informacionit;</li> <li>- Të krijojë një pasqyrë reale thelbësore për secilën kaptinë mësimore dhe vlerësojnë aspektin shkencorë duke krahasuar me atë praktik;</li> <li>- Të krijoj shkathtësi menaxhimi që nga mbledhja e kërkesave për softuer të ri, projektimin, kodimin, testimin, mirëmbajtjen dhe futjen në funksion të sistemit komunikues si produktit softuerik;</li> <li>- Të aftësohet për planifikimin dhe udhëheqjen e projekteve në fushën e teknologjive komunikuese në biznes;</li> <li>- Të jetë në gjendje t'i evidentoj dhe dokumentoj kërkesat e ndryshme të bizneseve dhe ofrimin e zgjidhjeve konkrete për komunikim sa më cilësor;</li> <li>- Të aftësohet për porositjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit dhe komunikimit;</li> <li>-Të jetë në gjendje të bëjë menaxhimin e projekteve softuerike dhe sistemeve harduerike në fushën e komunikimit në biznes;</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë / javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	15	15
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	3	3	9
<b>Totali</b>			<b>150 orë= 6 ECTS</b> (150:25=6)

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Mësimdhënia në këtë lëndë është e përqendruar në ligjërata dhe ushtrime. Ushtrimin e detyrave në grupe dhe në shtëpi. Në ligjërata përdoret metoda e shpjegimit dhe metoda interaktive përmes prezentimit me kinoprojektor. Marrja e shembujve praktikë nga sistemet e informacionit dhe praktikës në kohë reale.</p> <p>Në fund të ligjëratave studentët marrin detyra që duhet t'i bëjnë në shtëpi dhe t'i diskutojnë në orën vijuese bashkë me mësimdhënësin. Ligjëratat dhe ushtrimet përqendrohen në dy aspekte:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Studentët ta përvetësojnë njohuri të përgjithshme të projekteve të teknologjisë së komunikimit në biznes dhe</li> <li>2. Studentët të përvetësojnë aftësitë organizative në projektimin e sistemeve të ndryshme softuerike dhe rrjeteve kompjuterike</li> <li>3. Studentët të trajnohen për punë të pavarur e kryesisht punë të përbashkët në grupe në ndërtimin e sistemeve komunikuese.</li> </ol>
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kollokiumi-Testi i parë: 10 %</li> <li>- Kollokiumi-Testi i dytë: 10 %</li> <li>- Detyrat e shtëpisë: 10 %</li> <li>- Vijimi i rregullt, ligjërata, ushtrime dhe aktiviteti në klasë: 10 %</li> <li>- Punimi seminarikë: 10 %</li> <li>- Provimi përfundimtar prej 50 % gjer 100 %</li> </ul> <p>Totali: 100 % ose 100 pikë.</p> <p>Për të kaluar provimin:</p> <p>Shuma e pikëve të fituara duhet te jetë më e madhe se 49 pikë.</p> <p>Vlerësimi i përqindjeve në gjitha format e paraqitura merren parasysh vetëm në afatin e parë të provimit përkatësisht afatin janarit, gjersa për afatet tjera vlerësohet vetëm provimi!</p> <p>Nota e fituar sipas vlerave të pikëve:</p> <p>50-60 = <b>6</b>; 61-70 = <b>7</b>; 71-80 = <b>8</b>; 81-90= <b>9</b>; 91-100 = <b>10</b></p> <p>Provimi ka 100 pikë.</p> <p>Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese !</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. William A. Shay, Modern communications technology and networks, University of Wiskonsin – Green Bay, 2004</li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. B. Ruseti&amp;Kozeta Sevrani, Sistemet e Informacionit të Menaxhimit, Tiranë; ISBN9943-714-1-X</li> <li>3. King L, Lytinen K, Information Systems, the state of field, John Wiley &amp; Sons (2006)</li> <li>4. Grup autorësh, Teknologjia dhe Sistemet e Informacionit, 2011</li> <li>5. Selman Haxhijaha, Rrjetet kompjuterike, UBT, Prishtinë</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësim:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<b>Hyrje në Teknologjinë e Komunikimit në Biznes; Historik i shkurtër; Zhvillimi i telefonisë; Komunikimi kompjuterik; Format e tjera të komunikimit në biznes</b>

<i>Java e dytë:</i>	<b>Rrjetat kompjuterike;</b> Topologjia e magjistrale së përbashkët;; Topologjia Yll; Topologjia unazë; Topologjitë e kombinuara; Organizatat për vendosjen e standardeve; Sistemet e hapura dhe modeli OSI i organizatës ISO
<i>Java e tretë:</i>	<b>Strategjitë e lidhjeve;</b> Komutimi i mesazheve; Shtresa fizike; Shtresa e lidhjeve; Shtresa e rrjetit; Shtresa e transportit; Shtresa e sesionit; Shtresa e prezentimeve; Shtresa e aplikacioneve; Shtresat e Internetit;
<i>Java e katërt:</i>	<b>Mediumet për bartje dhe kodet;</b> Hyrje; Metalet përçuese; kabllot koaksiale; Fibrat optike; Komunikimet pa tela; Transferet mikrovalë; Transferet satelitore; Satelitët geostacionarë; LAN pa tela; Bluetooth; Teknologjitë Free Space Optics;
<i>Java e pestë:</i>	<b>Kodet;</b> Kodet e Morzeut; ASCII kodet; EBCDIC kodit; Unicodi
<i>Java e gjashtë:</i>	<b>Kollokfiumi i parë ;</b>
<i>Java e shtatë:</i>	<b>Sinjalet analoge dhe digjitale;</b> Hyrje; Skemat e kodimit digjital; NRZ kodimi; Manchester kodimi; Sinjalet analoge; Rezultatet e Furijeut; Zbatimi i rezultateve të Furijeut; Shpejtësia e bitëve-kanaleet pa zhurma; Kanalet me zhurma; Rezultati i shenonit;
<i>Java e tetë:</i>	<b>Konvertimi i sinjaleve digjitale në analoge;</b> Modulimi frekuencor; Modulimi amplitudë; Modulimi fazorë; Modulimi amplitudë katror; <b>Konvertimi i sinjaleve analoge në digjitale;</b> Modulimi impulsiv amplitudë; Modulimi impulsiv i koduar; Modemët; Konstelacioni i sinjalit; Standardet për modemët; Modemët kabllorë; DSL;
<i>Java e nëntë:</i>	<b>Vendosja e konektiveve;</b> Hyrje; Sistemi telefonik; Ruterimi i thirrjeve; Centralët private; Telefonat celularë; Faks makinat; Transferi serik dhe paralel; Transferi sinkron, asinkron dhe izokron; Komunikimet simplex, half-dupleks dhe full-dupleks; Standardet për interfejsë; EIA-232 interfejsi; X.21 interfejsi; USB; FireWire; Multipleksimi; Multipleksimi me ndarje të frekuencave; Multipleksimi me ndarje të kohës; Bartësit digjital;
<i>Java e dhjetë:</i>	<b>Komprimimi i të dhënave;</b> Hyrje; Kodet frekuencor të varura; Kodi i Hofmanit; Komprimimi aritmetikor; Run-Length kodimi; Vargjet e bitit të njëjtë; Vargjet me karaktere të ndryshme; Komprimimi faksimil; Kodimi relativ; Komprimimi Lampel-Ziv; Komprimimi i figurave; Komprimimi JPEG; GIF fajllat; Komprimimi i informacioneve multimediale MPEG; MP3;
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<b>Integriteti i të dhënave;</b> Hyrje; Teknikat e rëndomta për detektimin e gabimeve; Detektimi i gabimeve përmes vërtetimit ciklik-CRC(Cyclic Redundancy Check); Pjestimi i polinomeve; Funksionimi i CRC; Analiza e CRC-së; Korigjimi i gabimeve me metodën e Hamingut; Korigjimi i gabimeve të shumëfishta;
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<b>Mbrojtja e të dhënave;</b> Hyrje; Algoritmet për shifrim; Shifrimi polialfabetik; Shifrimi me çvendosje dhe në nivel të bitëve; Standardet për shifrim të të dhënave; Distribuimi dhe mbrojtja e çelësit; Shifrimi me çelës publik; Nënshkrimi digjital;
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<b>Rrjetat lokale;</b> Hyrje; Kontrolli i lidhjeve ndërmjet të dhënave; High-Level Data link Control(HDLC) protocol; Binary Synchronous Communications (BSC) protokol; Ethernet: IEEE standard 802.3; Implementimi fizik 10 Mbps Ethernet; Fast Etherneti (100 Mbps); 100Base TX; 100 Base FX; 100 Base T4; Gigabit Ethernet; 1000BaseX; 1000BaseT; Shpejtësitë më të mëdha se gigabitët;

<b><i>Java e katërbëdhjetë:</i></b>	<b>Lidhja e rrjetave;</b> Hyrje; Konektimi i shtresës 1- repititorët dhe hub-ët; Konektimi i shtresës 2-urat; Ruterimi; Tabelat e ruterimit; Urat transparente; Spanning tree algoritmi; Urat që shfrytëzojnë ruterimin burimorë; Komutatorë; Komutatorët dhe Etherneti i komutuar; Konektimi i shtresës 3; Tabelat e ruterimit; Ruterimi i centralizuar; Ruterimi i distribuuar;
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	<b>Kollokfiumi i dytë ;</b>

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti është i obliguar të vijojë në ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi i mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimmshënësit.